



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Elbasan më ____, ____, 2024

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Asfaltim i gjendjes ekzistuese të rrugës të Xhamisë, fshati Vreshtan, Njësia Administrative Shushicë”, me fond limit prej **11’015’909** (njëmbëdhjetë milion e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntë) **lekë (pa tvsh)**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkise për vitin 2024.

LLOJI PROCEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar -Punë”

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):45210000-2 - Punime ndërtimi**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit të miratuara nga APP me vendimin nr. 08, datë 23.09.2024.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar paguar **taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifatat vendore).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrjen në dorëzim të punimeve të kryera.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim, -Faturat tatimore për Situacionin përfundimtar.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Investitorit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojën e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 5 dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se vlera e fondit limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

- N.P - 1 A (Punime gjurmimi në tokë)
- N.P - 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale)
- N.S -18 A (Punime topogjeodezike)

-Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotesimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë perkatese dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndertimit.

Pikat e licensave janë përcaktuara në bazë të zerave të pershkruara në preventivin e projektit.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi A (edhe për herë të parë) 0 - 20 milion lekë.

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategori në respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
<i>N.P-1</i>	<i>Punime gjurmimi në tokë.</i>	<i>Punimet sipas preventivit Gjurmim dhe me ekskavator zingjir, 0.5 m³, në kanale gjeresi > 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>N.P-4</i>	<i>Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale</i>	<i>Punimet për asfaltimin e rrugës sipas preventivit: Shtrese Stabilizanti 8 cm; Shtrese binderi me granil guri kave, 5cm, me krah; Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri etj</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>
<i>N.S-18</i>	<i>Punime topogjeodezike</i>	<i>Punimet për piketimin, azhornimin topografik para</i>	<i>A</i>	<i>0-20 milion</i>

		<i>fillimit te punimeve sipas relacionit teknik</i>		
--	--	---	--	--

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administrator i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm;

- a) Kontratë pune noteriale
- b) Diplomë

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier ndertimi
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. Për këto arsye të paraqitet deklaratë perkatese nga Administratori i shoqërisë.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet

organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- 1 (nje) punonjës teknik ndertimi
- 1 (nje) punonjës teknik topograf
- 2 (dy) punonjes betonues
- 2 (dy) punonjes karpentier
- 2 (dy) punonjes shofere
- 1 (nje) punonjes manovrator eskavatorist
- 1 (nje) punonjes manovrator buldozerist
- 2 (dy) punonjes manovratore automakiniste
- 6 (gjashte) punonjes te thjeshte/ndihmes

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit.

Per punonjesit e kualifikuar te ndertimit te paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH”, i ndryshuar.

Për teknikun e ndërtimit, do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Ndersa per punonjesit shofer dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten dëshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certifikate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.

Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet e rënda në pronësi, duhet ti ketë operatorët e mjeteve në listëpagesë për dy muajt e fundit.

Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin, kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

<p><i>1 (nje) Teknik Ndertimi</i></p>	<p><i>Tekniku i ndertimi është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë gërmimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat per punetoret dhe ndjek ecurine e tyre gjate kohes se punes.</i></p>
<p><i>1 (nje) teknik topograf</i></p>	<p><i>Inxhinieri topograf</i> është i nevojshem për pëketimin, azhornimin topografik para fillimit të punimeve sipas rekomandimeve të përshkruara në relacionin teknik, punime që përfshihen në kategorinë NS-18</p>
<p><i>2 (dy) karpentiere</i></p>	<p><i>Karpentierët</i> janë të nevojshëm për punimet e strukturave monolite të betonit sipas zërave të preventivit. Bejnë pëketimin dhe armaturen anesore, bëjnë vendosjen e modinave për muret e betonit, ndërtojnë armaturen, apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kërkuar është bazuar në grafiku i punimeve, ku të gjitha punimet ku kërkohet prezencë e punonjësve karpentiere është parashikuar të realizohet në muajin e katërt, si dhe të përfunduarit të bërë bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo zë të punimeve të parashikuara në preventiv.</p>
<p><i>2 (dy) betonues</i></p>	<p>Betonuesi ndihmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do të derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos.</p> <p>Betonuesi është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit sipas zërave të preventivit: Struktura monolite betoni C 16/20, Struktura monolite betoni C 20/25, Shtrese betoni C 16/20, Shtrese betoni C20/25.</p>
<p><i>1 (nje) manovrator eskavatorist</i></p>	<p><i>Manovratori eskavatorist</i> është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si eskavator gërmimi, i cili është</p>

	<p>kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketij mjeti: Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet. Ne nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:</p> <p>a)-eskavator gërmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.</p>
2 (dy) shofere	<p>Shoferi eshte i nevojshem për drejtimin e kamionit. Numri i kerkuar eshte bazuar ne numrin e mjeteve dhe grafikun e e punimeve.</p>
1 (nje) manovratori buldozerist	<p>Manovratori buldozerist eshte i nevojshem per përdorimin e makinerive të rënda te ndertimit si rrul vibrues, grejderi, shtruese asfalto-betoni te cilat jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre makinerive: Cilindrim kasonete me rul; Shtrese Stabilizanti 8 cm; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri. Ne nenin 8, germa b, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:</p> <p>b)- buldozer gërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST.</p>
2 (dy) manovratore automakiniste	<p>Manovratori automakinist eshte i nevojshem per përdorimin e autobetoniereve, autopompe betoni, autobitumatriçe, te cila jane kerkuar pasi ne preventiv jane parashikuar punime qe kerkojne perdorimin e ketyre mjeteve : Shtrese binderi me granil guri kave, 5cm, me krah; Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri; Shtrese betoni C 16/20. Numri i kerkuar eshte bazuar ne numrin e mjeteve dhe grafikun e punimeve.</p> <p>Ne nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe</p>

	<p><i>dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës percaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmimeve të Aftësisë Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:</i></p> <p><i>c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:- autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për AUTOMAKINIST.</i></p>
--	---

2.3.6 Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij:

1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj.

Për punonjësin e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për dy muajt e fundit.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Këto kriterë janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve. Në mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.7 Nje punësim mesatar per tre muajt e fundit, i të paktën **20** (njëzet) personave të vërtetuar me :

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Argumentimi: Ky kriter është vendosurbazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punetore dhe personelin e kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj. Duke e bazuar në këto komponente AK përcaktoi stafin kryesor teknik (inxhinieret), një numër minimal punonjësish të kualifikuar për çdo lloj punimesh dhe një numër minimal punonjësish të thejshme/ndihmes. Nga ky numër rezultoi se për të përfunduar brenda afatit dhe me sukses zbatimin e kontratës operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë minimalisht një numër prej 20 punonjësish (stafi kryesor teknik + punonjës të kualifikuar + punonjës të thejshme/ndihmes). Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë për periudhën e kërkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.8 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr.	Lloji i mjetit	Njesia	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min. 10 ton	Cope	2	Ne pronesi ose me qira
2	Eskavator me zinxhir	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
3	Grejder	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
4	Vibrator betoni	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
5	Autobetoniere	Cope	2	Ne pronesi ose me qira
6	Autopompe betoni	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
7	Autobot uji	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
8	Asfaltoshtruese	Cope	1	Ne pronesioseme qira
9	Autobitumatrice	Cope	1	Ne pronesioseme qira
10	Rrul hekur - hekur	Cope	1	Ne pronesi ose me qira

11	Rrul vibrues	Cope	1	Ne pronesi ose me qira
----	--------------	------	---	------------------------

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesise, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerese, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e transportit me qera te paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për te trete dhe me qira. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, mjeteve dhe paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetë të tjera fizike, aftësitë organizative. Makinerite, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Numri i mjeteve, makinerive dhe pajisjeve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Percaktimi i makinerive sa me siper është bere referuar zërave të punimeve reflektuar ne tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
1	Eskavator me zinxhir	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	copë 1

2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton (AK ka vendosur te kerkoje minimalisht 2 mjete te tille per arsye te grafikut dhe volumit te konsiderueshem te materialeve qe do te transportohen.	Per transport dheu, binder, asfalt, zhavor.	cope 2
3	Grejder	Per punimet sipas preventivit: Per nivelimin e shtresave ne trupin e rruges: Shtrese Stabilizanti 8 cm	copë 1
4	Asfaltoshtruese	Per punimet sipas preventivit: Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	copë 1
5	Autobitumatrice	Per punimet sipas preventivit: Shtrese binderi me granil guri kave, 5cm, me krah; Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri.	copë 1
6	Autobot uji	Per punimet sipas preventivit: Shtrese Stabilizanti 8 cm, nenshtresa zhavori	copë 1
7	Autopompe betoni	Per punimet sipas preventivit: Per hedhjen e betonit ne veper: Shtrese betoni C 16/20.	copë 1
8	Autobetoniere	Per transport betoni per punimet sipas preventivit: Shtrese betoni C 16/20.	copë 2
9	Vibrator betoni	Per punimet e betonit sipas preventivit: Shtrese betoni C 16/20.	copë 1
10	Rrul hekur - hekur	Per punimet sipas preventivit qe kerkojne perdorimin e ketij mjete, ngjeshjen e shtresave te asfaltit: Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me	copë 1
11	Rrul vibrues	Per punimet sipas preventivit qe kerkojne perdorimin e ketij mjete: Cilindrim kasonete me rul; Shtrese Stabilizanti 8 cm;	copë 1

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Nërastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i tij bashkimiduhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë për të realizuar sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Projektet, Specifikimet Teknike dhe Relacionet per proceduren respektive jane hartuar nga inxhinieret e struktures se Bashkise Elbasan.Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290, date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 'Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'',

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.